



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA VI

Sesioni pranveror

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Mbledhja nr.20

Prishtinë, më 4.7.2018, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-204

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Igor Simiq, kryetar i Komisionit, Xhelal Sveçla dhe Danush Ademi zëvendëskryetarë, Kujtim Shala, Fadil Beka, Zoran Mojsilović, Jasmina Zhivković, Sasha Milosavljević, Rasim Selmanaj, Albert Kinolli, Mufera Shinik, Slobodan Petrović dhe Veton Berisha, anëtarë.

Mungoi: Duda Balje, anëtare .

Pjesëmarrësit tjerë: përfaqësues të OSBE-së Senad Karaahmetović dhe Smajl Demaj, përfaqësues të KDI-së, Artan Murati dhe Riza Nushi, këshilltar i Sekretariatit të KKK-së, Zijush Ahmeti, dhe Celal Iliaz, Drejtoria për Media dhe Marrëdhënie me Publikun.

Nga stafi mbështetës të Komisionit: Natasha Prica- Tishma dhe Drita Çarkaxhiu.

Mbledhjen e kryesoi: Igor Simiq, kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi i Projektregullores së Kuvendit të Kosovës dhe amendamenteve të Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit;
3. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-066 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 05/L-064 për Patentë Shofer dhe amendamenteve të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal;
4. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-067 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 04/L-063 për Hekurudhat e Kosovës dhe amendamenteve të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal;
5. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-068 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 2003/11 për Rrugë, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.03/L-120 dhe amendamenteve të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal;

6. **Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-069 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 05/L-088 për Rregullat e Trafikut Rrugor dhe amendamenteve të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal;**
7. **Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-070 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 04/L-179 për Transportin Rrugor dhe amendamenteve të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal;**
8. **Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-071 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 04/L-183 për Transportin Tokësor të Mallrave të Rrezikshme dhe amendamenteve të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal;**
9. **Të ndryshme.**

1. **Miratimi i rendit të ditës**

Kryetari, konstatoi se rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. **Shqyrtimi i Projektregullores së Kuvendit të Kosovës dhe amendamenteve të Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit;**

Kryetari, paraqiti për shqyrtim Projektregullorin e Kuvendit të Kosovës dhe kërkoi nga anëtarët e komisionit të deklarohen nëse kanë ndonjë propozim apo sugjerim në raportin me amendamente të Komisionit Funkcional.

Pasi jam anëtarë edhe në Komisionin për Legjislacion, ai ceku se tërë kohën ka qenë në rrjedha gjatë amendamentimit të projekt- Rregullores së Kuvendit. Ai ceku se me projektregulloren e re do të rregullohen shumë çështje të cilat kanë pas mangësi, dhe në momentin e miratimit të të njejtës do të fuqizohet puna e Kuvendit. Për arsyet e lartçekura, do të jetë pro vota e LS.

Pasi nuk pati diskutime shtesë, Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, nxori këtë:

Rekomandim

Projektregullorja e Kuvendit të Kosovës dhe amendamentet e propozuara nga Komisioni Funkcional, nuk cenojnë dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve, dhe rekomandohet të procedohet për miratim në Kuvend.

3. **Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-066 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 05/L-064 për Patentë Shofer dhe amendamenteve të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal;**

Kryetari, në fillim tha se grupi i projektligjeve të propozuara nga Komisioni Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal, ka për qëllim zbatimin e sigurisë në komunikacion, caktimi i masave penale dhe gjobave, dhe disa ndryshime teknike e korrektive gjuhësore.

Kryetari, paraqiti për shqyrtim Projektligjin nr.06/L-066 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 05/L-064 për Patentë Shofer dhe kërkoi nga anëtarët e komisionit të deklarohen nëse kanë ndonjë propozim apo sugjerim në raportin me amendamente të Komisionit Funkcional.

Pas shqyrtimit të Projektligjit dhe Raportit me amendamente të Komisionit FunkSIONAL, Komisioni nxori këtë:

Rekomandim

Projektligji nr.06/L-066 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 05/L-064 për Patentë Shofer dhe amendamentet e propozuara nga Komisioni FunkSIONAL, nuk cenon dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve, dhe rekomandohet të procedohet për miratim në Kuvend.

4. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-067 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 04/L-063 për Hekurudhat e Kosovës dhe amendamenteve të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal;

Kryetari, paraqiti për shqyrtim Projektligjin nr.06/L-067 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 04/L-063 për Hekurudhat e Kosovës dhe kërkoi nga anëtarët e komisionit të deklarohen nëse kanë ndonjë propozim apo sugjerim në raportin me amendamente të Komisionit FunkSIONAL.

Pas shqyrtimit të Projektligjit dhe Raportit me amendamente të Komisionit FunkSIONAL, Komisioni nxori këtë:

Rekomandim

Projektligji nr.06/L-067 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 04/L-063 për Hekurudhat e Kosovës dhe amendamentet e propozuara nga Komisioni FunkSIONAL nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve, dhe rekomandohet të procedohet për miratim në Kuvend.

5. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-068 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 2003/11 për Rrugë, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.03/L-120 dhe amendamenteve të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal;

Kryetari, paraqiti për shqyrtim Projektligjin nr.06/L-068 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 2003/11 për Rrugë, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.03/L-120 dhe kërkoi nga anëtarët e komisionit të deklarohen nëse kanë ndonjë propozim apo sugjerim në raportin me amendamente të Komisionit FunkSIONAL.

Pas shqyrtimit të Projektligjit dhe Raportit me amendamente të Komisionit FunkSIONAL, Komisioni nxori këtë:

Rekomandim

Projektligji nr.06/L-068 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 2003/11 për Rrugë, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.03/L-120 dhe amendamentet e propozuara nga Komisioni FunkSIONAL, nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve, dhe rekomandohet të procedohet për miratim në Kuvend.

6. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-069 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 05/L-088 për Rregullat e Trafikut Rrugor dhe amendamenteve të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal;

Kryetari, paraqiti për shqyrtim Projektligjin nr.06/L-069 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 05/L-088 për Rregullat e Trafikut Rrugor, dhe kërkoi nga anëtarët e komisionit të deklarohen nëse kanë ndonjë propozim apo sugjerim në raportin me amendamente të Komisionit FunkSIONAL.

Kryetari hodhi në votim Projektligjin me Raport amendamentet e Komisionit FunkSIONAL, dhe konstatoi se Komisioni i miratoi të njëjtat me 10 (dhjetë) vota për dhe 4 (katër) abstenime, dhe nxori këtë:

Rekomandim

Projektligji nr.06/L-069 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 05/L-088 për Rregullat e Trafikut Rrugor dhe amendamentet e propozuara nga Komisioni FunkSIONAL nuk cenon dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve, dhe rekomandohet të procedohet për miratim në Kuvend.

7. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-070 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 04/L-179 për Transportin Rrugor dhe amendamenteve të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal;

Kryetari, paraqiti për shqyrtim Projektligjin nr.06/L-070 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 04/L-179 për Transportin Rrugor, dhe kërkoi nga anëtarët e komisionit të deklarohen nëse kanë ndonjë propozim apo sugjerim në raportin me amendamente të Komisionit FunkSIONAL.

Kryetari hodhi në votim Projektligjin me Raport amendamentet e Komisionit FunkSIONAL, dhe konstatoi se Komisioni i miratoi të njëjtat me 10 (dhjetë) vota për dhe 4 (katër) abstenime, dhe nxori këtë:

Rekomandim

Projektligji nr.06/L-070 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 04/L-179 për Transportin Rrugor dhe amendamentet e propozuara nga Komisioni FunkSIONAL nuk cenon dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve, dhe rekomandohet të procedohet për miratim në Kuvend.

8. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-071 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 04/L-183 për Transportin Tokësor të Mallrave të Rrezikshme dhe amendamenteve të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal;

Kryetari, paraqiti për shqyrtim Projektligjin nr.06/L-071 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 04/L-183 për Transportin Tokësor të Mallrave të Rrezikshme, dhe kërkoi nga anëtarët e komisionit të deklarohen nëse kanë ndonjë propozim apo sugjerim në raportin me amendamente të Komisionit FunkSIONAL.

Kryetari hodhi në votim Projektligjin me Raport amendamentet e Komisionit Funkcional, dhe konstatoi se Komisioni i miratoi të njëjtat me 10 (dhjetë) vota për dhe 4 (katër) abstenime, dhe nxori këtë:

Rekomandim

Projektligji nr.06/L-071 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 04/L-183 për Transportin Tokësor të Mallrave të Rrezikshme dhe amendamentet e propozuara nga Komisioni Funkcional nuk cenojnë dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve, dhe rekomandohet të procedohet për miratim në Kuvend.

9. Të ndryshme.

Kryetari, propozoi që në mbledhjen e radhës, Komisioni të rishqyrtojë Raportin e punës për vitin 2018, që të analizohen aktivitetet e kryera dhe të definohen planet për gjashtëmujorin e dytë.

Veton Berisha, kërkesa e tij ishte që të përsëritet ftesa për Ministrin e Punëve të Brendshme për të raportuar lidhur me çështjen e shpalljes së konkursit të policisë dhe përfaqësimi i komuniteteve. Gjithashtu, të ftohet Ministri për Komunitete dhe Kthim, me arsye të raportimit lidhur me implementimin e projektit për ndërtimin e shtëpive për komunitetin joshumicë. Në kuadër të këtyre propozimeve, u pajtuan njëzëri anëtarët e Komisionit.

Kryetari, konstatoi se me shumicë të votave, Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, nxori këtë:

Përfundim

- I. Që administrata për mbështetje të Komisionit të dërgojë ftesë ministrit të Ministrisë të Punëve të Brendshme, me qëllim që të raportojë lidhur me shpalljen e konkursit policor të Kosovës dhe përfaqësimi i komuniteteve.*
- II. Në takimin e radhës, të ftohet ministri i Ministrisë së Komuniteteve dhe Kthim, me qëllim të raportojë lidhur me implementimin e projektit për ndërtimin e shtëpive për komunitetin joshumicë.*

Mbledhja përfundoi në orën 10:40.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i Komisionit

**Kryetar i Komisionit,
Igor Simiq**